

MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

12 - MUJORI - VITI 2013

Programet Buxhetore:

1. Planifikim Administrim, Menaxhim
2. Trashëgimia Kulturore
3. Arti dhe Kultura
4. Mbështetje për Kultet Fetare

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2013**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, kreu VIII, neni 65 “Monitorimi”, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2014”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” paragrafi VI “Raportet e Monitorimit” dhe Udhëzimit nr. 1/1, datë 19.02.2013 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2013”, shtojcat nr. 7-11, Ministria e Kulturës, për 12 - mujin e vitit 2013, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për 12 - **mujin e vitit 2013**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 12- muji 2013		Realizimi 12- muji 2013		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	146,830	10.32%	145,452	10.47%	99.06%
2.	Trashëgimia Kulturore	385,760	27.11%	364,733	26.24%	94.55%
3.	Arti dhe Kultura	762,062	53.55%	754,268	54.27%	98.98%
7.	Programe per Kultet	128,260	9.01%	125,379	9.02%	97.75%
	Totali	1,422,912	100.0%	1,389,832	100.0%	97.68%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	0	0	0	0	0

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se, buxheti është realizuar në masën 98%, ku rreth 54 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 99%, ndjekur nga programi ”Trashëgimia Kulturore” shpenzimet e të cilit zënë rreth 27 % të totali dhe janë realizuar në masën 95%, programi ”Planifikim Menazhimi” shpenzimet e të cilit zënë rreth 10 % dhe janë realizuar në masën 99% si dhe programi mbeshtetje per kultet fetare shpenzimet e të cilit zënë rreth 9% dhe janë realizuar në masën 98% .

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomike

G r	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2013		Realizimi 12- mujori I 2013		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	890,073	62.6	877.622	63.1	98.6
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	393.993	27.7	384.401	27.7	97.6
12	01110	231	Kapitale	138,846	9.8	127,809	9.2	92.1
			TOTALI	1422,912	100	1,389,832	100	97.7
12	01110	231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	1422,912	100	1,389,832	100	97.7

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 12-mujorin e vitit 2013 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 99%, shpenzimet korente 98 %, shpenzimet kapitale, janë realizuar në masën 92%.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për investime në programin e Trashëgimisë Kulturore , kryesisht pagesa për TVSH e financimeve të huaja si dhe nga mosrealizimi i një pjesë të shpenzimeve korrente të cilat do të analizohen për cdo program.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: "PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM"

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2013		Realizimi 12- mujori 2013		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	111.230	75.8	110.072	75.7	99.0
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	34,600	23.6	34.424	23.7	99.5
12	01110	231	Kapitale	1,000	0.7	956	0.7	95.6
			TOTALI	146,830	100	145,452	100	99.1

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 99%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 76 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99%. Shpenzimet korrente zënë rreth 24% të totalit dhe janë realizuar në masën 100%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 0.7% dhe janë realizuar në masën 96 %

Mosrealizimi i fondeve në masën 0.9% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në gjashtë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2013	Buxhet Plan 2013	Buxhet/Plan 12-mujori 2013	Buxhet/Fakt 12-mujori 2013
A-01363	Ristrukturim	39,961.8	39,961.8	74,132	73,436
B-02113	Pajisje elektronike dhe elektrike	2,054.2	6,527.1	6,527.0	6,466.0
C-02459	Akte ligjore e nenligjore	43,117.0	43,117.0	41,366.0	40,978
D-02496	Nenshkrim marreveshesh	41,542.0	41,542.0	4,154	4,115
F-04248	Auditime	12,320.0	12,320.0	7,228	7,160
E-04177	Pagesa vendimesh gjyqesore	6,896.0	6,896.0	6,896	6,831
G-04317	Paisje zyresh		6,527.0	6,527	6,466
Totali		145,891.0	156,890.9	146,830.5	145,451.8

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithsëm të MTKRS-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Realizimi i produktit paisje elektronike dhe paisje zyresh është realizuar në zbatim të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe regjistrin të parashikimit publik të vitit 2013.

Gjatë vitit 2013 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nënligjore” përfajson miratimin e 29 akteve nënligjore.

Në realizimin e Produktit “Nënshtkrim Marrëveshesh” për vitin 2013 përmendim nënshtkrimin e programit ekzekutiv në arsim, kulturë dhe shkencë midis KM të RSH dhe Republikës Arabe të Egjiptit për 2013-2016 e tje.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

MINISTRIA E KULTURËS

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2013		Realizimi 12- mujori 2013		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	256,500	66.5	247,501	67.9	96.5
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	72.087	18.7	66.745	18.3	92.6
12	01110	231	Kapitale	57.173	14.8	50,486	13.8	88.3
			TOTALI	385,760	100	364,733	100	94.5
12	01110	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	385,760	100	364,733	100	94.5

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 95%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 67% të totalit dhe janë realizuar në masën 97%, shpenzimet korrente zënë rreth 19% të totalit dhe janë realizuar në masën 93% dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 15% dhe janë realizuar në masën 88%.

Mosrealizimi në masën 5,5 % e totalit, përfaqëson kryesisht mos realizim të fondit të pagave si rrjedhojë e ristrukturimit të institucioneve të këtij programi si dhe nga mosrealizimi në shpenzimet kapitale për arsye të mos pagesave të TVSH së financimeve të huaja të cilat janë në proces realizimi por në ministrinë e kulturës nuk kanë paraqitur fatura për likuidim.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë				08220
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2013	Buxhet Plan 2013	Buxhet/Plan 12-mujori 2013	Buxhet/Fakt 12-mujori 2013
A-00324	Banesa te restauruara	80,705	103,070	99,680	93,080
B-00324	Muze te rikonstruktuar dhe permiresuar ne infrastrukture	75,000	85,000	82,205	80,366
C-00324	Objekte kulti te restauruara	12,000	12,400	11,992	11,723
D-00324	Qendra historike te restauruara	78,000	85,000	82,205	80,367
F-00324	Kartela te inventarizuara	7,500	7,200	6,963	6,807
G-00324	Aktivitetet te organizuara	40,000	46,768	45,230	44,221
H-00324	Infrastrukture e permiresuar ne 7 parqe arkeologjike	54,500	59,440	57,485	48,169
	Totali	347,705	398,878	385,760	364,733

Produktet e planifikuara në këtë program në përgjithësi janë realizuar:

- **Produkti Objekte kulti te restauruara, Qendra historike te restauruara**

Janë kryer mirrmbajta në objekte kulti dhe qendra historike si dhe vazhdon pagesa e shpenzimeve të TVSH-së për projektet:

1. IPA qendrat historike II, Projekt i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri – IPA 2009, “Mbështetje për zhvillimin e qendrueshëm dhe të integruar të trashëgimisë kulturore dhe historike në Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Berat” ky projekt është në fazën përfundimtare.

2. UNDP/UNESCO, rimbursim të TVSH-së në kuadër të mbështetjes së dhënë për disa projekte të përqendruara në tre qendrat, Kukës, Gjirokastrë, Vlorë. Gjatë vitit 2013 është mbështetur një pjesë e projektit “ARTGOLD 2 Albania” dhe Projektit për përmirësimin e infrastrukturës në Muzeun Historik Kombëtar. Projektet janë në fazën e marrjes në dorëzim dhe likuidimet do të kryhen gjatë vitit 2014.

- **Produkti Kartela të inventarizuara**

- **Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore**, në kuadër të projektit afatgjatë “Krijimi i rrjetit kombëtar informatik i trashëgimisë kulturore “ punon për katagolimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në fushat Arkeologjisë, Artit pamor, Etnografisë, Arkitekturës, etj. Gjatë vitit janë kataloguar mbi 4000 objekte.

- **Aktivitete te organizuara**

Gjatë vitit 2013 janë zhvilluar Aktivitete të Trashegimise Kulturore Jomateriale si :

- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë, në qytetin e Lezhës prill 2013.
- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë Toske, në qytetin e Beratit maj 2013.

3. Programi: “ ARTI DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2013		Realizimi 12- mujori 2013		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig,Shoq	511,108	67.1	509,755	67.6	99.7
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	177,281	23.3	173,861	23.1	98.1
12	01110	231	Kapitale	73,673	9.7	70,652	9.4	95.9
			TOTALI	762,062	100	754,268	100	99.0

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 99%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 67% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet korrente zënë rreth 23% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 10% dhe janë realizuar në masën 96%. Mosrealizimi i fondeve në masën 1% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale dhe ato korrente.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura					08230
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit					
	Emri Produktit	PBA Plan 2013	Buxhet Plan 2013	Buxhet/Plan 12-mujori 2013	Buxhet/Fakt 12-mujori 2013	
A-00325	Fonde të perfituara nga aderimet në programet komunitare si dhe asistencë për rritjen e kapaciteteve të administratës	3,370	3,370	3,370	2,247	
B-00325	Bashkefinancim për veprimtaritë për piken e kontaktit (CCP), Kultura 2007-2013	1,400	1,400	1,400	1,400	
C-00325	Pjesëmarrje në veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare	10,140	10,140	10,140	9,112	
D-00325	Promovimi i imazhit ndërkombëtar në hapësirat kulturore ndërkombëtare	11,000	11,000	11,000	10,263	
E-00325	Evidentimi, Promovimi dhe angazhimi i artisteve të rinj pranë institucioneve publike të artit	14,000	15,000	15,000	14,700	
F-00325	Realizimi i edicioneve të përvitshme ku përzgjidhen dhe vlerësohen autorët dhe krijimtaria më e mirë e vitit	14,916	14,500	14,500	13,424	
G-00325	Realizimi i veprimtarive në nderim të përvjetoreve të data dhe viteve historike për personaliteteve të shquara të Kultures	5,500	5,574	5,574	5,574	
H-00325	Mbeshtetje dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore	14,000	14,000	14,000	14,000	
I-00325	Krijimi i arkivit dixhital me fondin e vlerave të rralla në institucionet publike të artit dhe krijimin e ekselit të publikut në këtë pjesë	19,024	19,024	19,024	18,219	
J-00325	Ndërgjegjësimi i opinionit publik dhe grupet e interesit për rolin dhe përgjegjësitë mbi respektimin e të drejtës së autorit në Shqipëri	25,700	25,700	25,700	23,175	
K-00325	Rritja e ekselit të publikut pranë institucioneve publike të artit dhe kultures në informacion, në programacion dhe në veprimtari	455,506	570,000	575,854	575,854	
L-00325	Ambiente të rikonstruara në institucionet publike të artit	65,479	64,000	64,000	64,000	
M-00325	Aktivitetet për kremtimin e ditëve kombëtare dhe festave tradicionale të minoritetit në Shqipëri	2,500	2,500	2,500	2,300	
Totali		642,535	756,208	762,062	754,268	

Për Programin “Arti dhe Kultura”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën në MK, në zbatim të politikave dhe prioritetëve institucionale në këtë fushë, ka zhvilluar një mori aktiviteteve gjithëpërfshirëse në bashkërendim me institucionet qendrore të

artit dhe kulturës, si dhe operatorë të tjerë të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me realizimin e produkteve;

❖ ***Aderimi në programe komunitare***

- Duke marrë në konsideratë se programet në të cilat MK është pjesë, përkatësisht programi “Kultura 2007-2013” dhe programi “Europa për Qytetarët 2007-2013”, ishin në përfundim të kohëzgjatjes së tyre, nga Agjencitë ekzekutuese pranë Delgacionit European u lançuan vetëm disa nga thirrjet për aplikim. Ndër to, operatorët dhe institucionet shqiptare mund të merrnin pjesë vetëm në disa prej tyre, duke bërë që aplikimet të ishin më të pakta në numër për vitin 2013.

❖ ***Bashkëfinancim për veprimtaritë për pikën e kontaktit (CCP), Kultura 2007-2013***

- Pikat e kontaktit realizuan 2 ditë informuese të cilat synuan informimin dhe vizibilitetin e këtyre programeve. Aktivitetet u mbajtën në Ministri të Kulturës dhe Hotel Tirana.
- Gjithashtu pikat e kontaktit kanë marrë pjesë në mbledhjen zyrtare të organizuar nga Angjensia koordinuese për programin e kulturës në Dublin, Irlandë.

❖ ***Promovimi i imazhit në arenën artistiko-kulturore ndërkombëtare.***

- Janë zhvilluar veprimtari të ndryshme artistiko kulturore në kuadër të promovimit të imazhit në arenën ndërkombëtare.
- Janë realizuar bashkëpunime me institucione dhe organizma homologë në kuadër të bashkëpunime të ndërsjellta kulturore artistike.

➤ ***Rikonstruksione të pjesshme dhe blerje pajisjesh në institucionet kombëtare kulturore në vend.***

Përmirësimi në kushte bashkëkohore i infrastrukturës dhe shërbimit ndaj publikut në institucionet qendrore të artit dhe kulturës.

❖ ***Realizimi i veprimtarive në nderim të përvjetorëve të datave dhe viteve historike për personaliteteve të shquara të Kulturës***

Janë zhvilluar veprimtari të ndryshme artistiko-kulturore në kuadër të personaliteteve në fushën e artit dhe kulturës.

Veprimtari artistike në kuadër të festave Kombëtare, si dhe festave të fundvitit.

- Realizimi i Natës së Bardhë, më 29 Nëntor, për të cilën u angazhuan gjithë institucionet kulturore shtetërore, të cilat ishin të hapura falas për publikun:
 - a. Teatri i Operas dhe Baletit – “Nata e Bardhë Muzeale”
 - b. Galeria Kombëtare e Arteve – “Natë e Gjatë në Muze”
 - c. Muzeu Historik Kombëtar – “Nata e Bardhë në Muze”
 - d. Cirku Kombëtar – “Nata e Bardhë”
 - e. Teatri i kukullave – “Nata e Bardhë”

❖ ***Veprimtari kulturore me minoritetet në Shqipëri***

- Janë zhvilluar aktivitete kulturore-artistike për ditët e minoriteteve në Shqipëri.
- Kremtimi i festave kombëtare të minoriteteve në Shqipëri.
- Bashkëpunime me shoqata dhe individ për realizimin e veprimtarive kushtuar komuniteteve në Shqipëri.

❖ ***Fondi për artistët e rinj në institucionet kombëtare të varësisë***

- Ka vijuar mbështetja ndaj të rinjve, të angazhuar në projekte pranë Galerisë Kombëtare të Arteve, Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit.

❖ ***Ndërgjegjësimi i opinionit publik dhe grupet e interesit për rolin dhe përgjegjësitë mbi respektimin e të drejtës së autorit në Shqipëri***

- Ka vijuar sensibilizimi i opinionit publik nëpërmjet fushatave sensibilizues dhe mjeteve të informimit.
- Realizimi i spoteve televizive nga Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit

❖ ***Ambiente të rikonstruara në institucionet publike të artit***

Realizuar rikonstrukcionet e disa institucioneve vendore dhe qendrore të kulturës, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimit ndaj publikut dhe rritjen e cilësisë në zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Përmirësimi në kushte bashkëkohore i infrastrukturës dhe shërbimit ndaj publikut në Bibliotekën Kombëtare.

❖ ***Rritja e eksedit të publikut pranë institucioneve publike të artit dhe kulturës në informacion, në programacion dhe në veprimtari***

- Në kuadër të politikave institucionale të MK "Edukimit të artit përmes kulturës" ka patur një angazhim të plotë në çdo institucion arti për promovimin e aktiviteteve artistike.

❖ ***Realizim i nismave dhe projekteve që rrjedhin nga prioritetet vjetore të MK***

- Ka vijuar mbështetja e projekteve kulturore artistike në kuadër të politikave institucionale.

❖ ***Aktivitetet për kremtimin e ditëve Kombëtare dhe festave tradicionale të minoritetit në Shqipëri***

- Kremtimi i festave kombëtare të minoriteteve në Shqipëri
- Bashkëpunim me individ dhe shoqatat që përfaqësojnë minoritetet në vendin tonë, me qëllim realizimin e veprimtarive kushtuar komuniteteve në Shqipëri.

4. Programi: "KULTET FETARE"

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2013		Realizimi 12- mujori 2013		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	11,235	8.8	10,294	8.2	91.6
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	110,025	85.8	109,370	87.2	99.4
12	01110	231	Kapitale	7,000	5.5	5,715	4.6	81.6
			TOTALI	128,260	100	125,379	100	97.8

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 98%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 9% të totalit dhe janë realizuar në masën 92%. Shpenzimet korrente zënë rreth 86% të totalit dhe janë realizuar në masën 99%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 6% dhe janë realizuar në masën 82%. Mosrealizimi i fondeve në masën 2.2% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale dhe paga e sigurime shoqërore.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi	Kultet Fetare					08480
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit				
		PBA Plan 2013	Buxhet Plan 2013	Buxhet/Plan 12-mujori 2013	Buxhet/Fakt 12-mujori 2013	
A -03535	Baza ligjore e plotësuar me akte ligjore dhe nenligjore	22,396	22,396	18,384	16,944	
B -03535	Takime për krijimin e grupeve "Ad-hoc" të punës	1,938	1,938	4,714	3,273	
C- 03535	Mbeshtetje financiare të bashkësive fetare	80,162	105,162	105,162	105,162	
	Totali	104,496	129,496	128,260	125,379	

Nga tre produktet e planifikuara është realizuar plotësisht produkti mbështetje për bashkësitë fetare, dy produktet e tjera nuk janë realizuar plotësisht për arsye objektive.